



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 160

Tiranë – E mërkurë, 10 shtator 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 164, datë 31.7.2025	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Albanian Energy Supplier 2’ sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, dhe në vendimin nr. 68, datë 3.3.2023.....	20995
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 165, datë 31.7.2025	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 199, datë 3.8.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘NRG Power’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”.....	20996
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 166, datë 31.7.2025	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 51, datë 3.3.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Deliu 3D’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Shiroku’, me kapacitet të instaluar 1.6 mw”.....	20997
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 167, datë 31.7.2025	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 107, datë 23.5.2025, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë ‘Deliu 3D’ sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”.....	20999
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 168, datë 31.7.2025	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 191, datë 6.6.2023, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SPV Blue 1’ sh.p.k., për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve të paluajtshme të centralit fotovoltaiik ‘Blue 1’, në favor të ‘Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., SICAV-SIF”.....	21001
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 169, datë 31.7.2025	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 147, datë 24.4.2023, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë ‘SPV Blue 1’ sh.p.k., si mjet (barrë siguruese) për garantimin e detyrimit ndaj ‘Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., SICAV-SIF”.....	21003

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 171, datë 31.7.2025	Mbi licencimin e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 30 mw.....	21004
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 172, datë 31.7.2025	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Global Technical Mechanics” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 12 mw.....	21006
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 173, datë 31.7.2025	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Global Technical Mechanics” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike	21008
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 174, datë 31.7.2025	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Dimax Albania” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.....	21009
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 175, datë 31.7.2025	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Construction Energy Parts (C.E.P)” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.....	21011
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 176, datë 31.7.2025	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Hydropower” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.....	21013
	Ndreqje gabimi material në vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, “Çështja Maçi kundër Shqipërisë”, kërkesa nr. 21051/10, datë 4.7.2024, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 141, datë 8.8.2024.....	21015

**VENDIM****Nr. 164, datë 31.7.2025****MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 258, DATË 21.12.2021, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘ALBANIAN ENERGY SUPPLIER 2’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”, DHE NË VENDIMIN NR. 68, DATË 3.3.2023**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve, me nr. 1368/3 prot., datë 24.7.2025, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Yldirim Energy Europe Albania’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike’, i ndryshuar”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 258, datë 21.12.2021, ka licencuar shoqërinë “Albanian Energy Supplier 2”, aktualisht e identifikuar me emrin “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar. Referuar këtij vendimi të ndryshuar me vendimin nr. 68, datë 3.3.2023, është vendosur detyrimi për shoqërinë, që të depozitojë në ERE informacion mbi sistemit IT me fillimin e operimit dhe të depozitojë kontratën e huapërdorjes të rinovuar, jo më vonë se 1 (një) muaj pas rinovimit të saj. Në bazë të vendimit nr. 68, datë 3.3.2023, shoqëria “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k. ka detyrimin të raportojë periodikisht çdo muaj sipas kushtit të vendosur në pikën 3, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 258/2021.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresat nr. 1368 prot., datë 18.3.2025 dhe nr. 1368/1 prot., datë 14.5.2025, duke i rikujtuar detyrimet që shoqëria ka në lidhje me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021, të ndryshuar.

- Shoqëria, me shkresën nr. 1368/2 prot., datë 28.5.2025, ka deklaruar se nuk e ushtron ende veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike. Në lidhje me sistemin IT dhe realizimin e procesit të faturimit sqaron se është në proces negocimi e në momentin e mbylljes së marrëveshjes do ta përcjellë atë në ERE.

- Shoqëria ka depozituar në ERE amendimin e kontratës së nënqirasë, të lidhur më datë 1.2.2024, ku rezulton se palët kanë rënë dakord që afati i kontratës, i cili përfundon më datë 1.2.2026, të zgjatet edhe me një vit, duke përfunduar më datë 1.0.2027.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në përputhje me vendimin nr. 258, datë 21.12.2021, të ndryshuar, detyrimi për dorëzimin e informacionit mbi sistemin IT mbetet në fuqi në kushtet që shoqëria, siç bën me dije dhe rezulton nga të dhënat që ERE disponon, nuk ka filluar ende ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit me energji elektrike. Shoqëria ka bërë me dije se është në proces të negocimit. Deri në atë moment, kushti për dorëzimin e informacionit për sistemin IT vlerësohet të qëndrojë në fuqi, duke saktësuar që shoqëria duhet të informojë për sa më sipër.

- Lidhur me detyrimin për raportim periodik mujor, sipas vendimit nr. 258, datë 21.12.2021, të ndryshuar me vendimin nr. 68, datë 3.3.2023, shoqëria ka vijuar të raportojë në mënyrë të vazhdueshme mbi statusin e veprimtarisë së saj, duke deklaruar se nuk ka nisur ende aktivitetin.

- Për sa i përket detyrimin për të depozituar kontratën e huapërdorjes së rinovuar, shoqëria ka përmbushur këtë kusht, duke depozituar pranë ERE-s amendimin e kontratës së nënqirasë të lidhur më datë 1.2.2024.

- Me depozitimin e kontratës së mësipërme, shoqëria ka përmbushur detyrimin e parashikuar në pikën 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021, të ndryshuar. Duke qenë se kontrata është në fuqi deri më datë 1.2.2027 dhe mbulon gjithë periudhën e mbetur të licencës (deri më 21.12.2026), vlerësohet që pika 4 e vendimit të licencimit të shfuqizohet si e përmbushur.



4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se pika 4, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021, duhet të shfuqizohet, pasi shoqëria “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k. e ka përmbushur kushtin përkatës të përcaktuar në këtë pikë.

- Duke qenë se shoqëria ende nuk ka filluar operimin në veprimtarinë e licencuar dhe për rrjedhojë, raportimi periodik mujor nuk ka objekt zbatimi praktik, vlerësohet e arsyeshme shfuqizimi i këtij detyrimi. Në të njëjtën kohë, vlerësohet të mbetet në fuqi detyrimi për depozitimin e informacionit mbi sistemin IT pranë ERE-s, sipas përcaktimeve të pikës 3, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021, të ndryshuar, si më poshtë “3. Me fillimin e operimit, shoqëria “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k. të depozitojë në ERE informacion mbi sistemin IT.”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të ndryshojë pikën 3, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021, të ndryshuar, si më poshtë: “3. Me fillimin e operimit, shoqëria “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k. të depozitojë në ERE informacion mbi sistemin IT.”.

2. Të shfuqizojë pikën 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021, të ndryshuar.

3. Të shfuqizojë pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 68, datë 3.3.2023.

4. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 165, datë 31.7.2025

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 199, DATË 3.8.2022, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘NRG POWER’ SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve, me nr. 1369/4 prot., datë 24.7.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 199, datë 3.8.2023, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘NRG Power’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike’, i ndryshuar”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “NRG Power” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 199, datë 3.8.2022, ka licencuar shoqërinë “NRG Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke vendosur, ndër të tjera, edhe disa kushte për dokumentimin e instalimit të sistemit IT, kontratën e rinovuar të qirasë jo më vonë se data e fundit e afatit të vlefshmërisë së saj (brenda datës 31.12.2024) dhe se ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- ERE, me shkresat nr. 1369 prot., datë 18.3.2025, nr. 1369/1 prot., datë 14.5.2025, i kërkoj shoqërisë “NRG Power” sh.p.k. informacion/dokumentacion, në kuadër të plotësimit të pikave 2 dhe 3, të vendimit nr. 199/2022.



- Me shkresën nr. 1369/2 prot., datë 27.5.2025, shoqëria “NRG Power” sh.p.k., në kuadër të përmbushjes së pikës 2 të vendimit të licencimit, ka informuar se ka zhvilluar një sistem CRM (menaxhim klientësh) dhe një platformë faturimi (*billing module*), të bazuar në “Microsoft Dynamics 365 Business Central” dhe “Microsoft Dynamics 365 Sales Professional”, të vendosur në infrastrukturë serverësh të rajonit të Bashkimit Evropian. Sipas deklarimeve të shoqërisë, ky sistem mundëson aksesin përmes faqes zyrtare dhe aplikacioneve në pajisje *smart* si për personelin, ashtu edhe për klientët, dhe përfshin funksionalitete të plota për menaxhimin e marrëdhënies me klientët, faturimin, historikun e pagesave, suportin dhe komunikimin.

- Në kuadër të pikës 3, shoqëria ka depozituar kontratën e qirasë të lidhur më datë 1.1.2025, me një afat prej 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj, me të drejtë ripërtëritjeje maksimumi dhe me një vit tjetër, afat ky i cili fillon më datë 1.1.2025 dhe mbaron më datë 31.12.2027.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Me depozitimin e informacionit të sipërcituar dhe në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, përkatësisht në pikën 2.4, germa “b”, ku citohet se: aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu, informacion mbi sistemin IT, me të cilin do të operojë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi, me qëllim realizimin e procesit të faturimit për klientët, vlerësohet se shoqëria ka plotësuar kushtin e lënë në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 199/2022, e si e tillë vlerësohet të shfuqizohet.

- Me depozitimin e kontratës së qirasë, shoqëria “NRG Power” sh.p.k. ka plotësuar kushtin e lënë në pikën 3, të vendimit të Bordit të ERE-s nr.199, datë 3.8.2022, duke marrë parasysh që afati i vlefshmërisë së kontratës e mbulon të gjithë periudhën e licencimit, si e tillë vlerësohet që pika 3 të shfuqizohet.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta

nxjerrë atë, vlerësohet se pikat 2 dhe 3, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 199, datë 3.8.2022, duhet të shfuqizohen, pasi shoqëria “NRG Power” sh.p.k. i ka përmbushur kushtet përkatëse.

- Me shfuqizimin e pikave 2 dhe 3, të vendimit nr. 199/2022, nuk gjen më zbatim as pika 4 e këtij vendimi ndaj vlerësohet shfuqizimi i saj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikat 2, 3 dhe 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 199, datë 3.8.2022.

2. Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 166, datë 31.7.2025

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 51, DATË 3.3.2025, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘DELIU 3D’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘SHIROKU’, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1.6 mw”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të



Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 186/12 prot., datë 16.7.2025, “Mbi ndryshimin e vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 51, datë 3.3.2025, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Deliu 3D’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Shiroku’, me kapacitet të instaluar 1.6 mw””, konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Deliu 3D” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 51, datë 3.3.2025, ka vendosur të licencojë shoqërinë “Deliu 3D” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Shiroku”, me kapacitet të instaluar 1,6 mw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përroit të Holtës dhe përroit të Hotomizës me derdhje në përroin e Holtës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan, për një afat 30-vjeçar subjekt i kushteve ndër të tjera: 2. Për të filluar operimin/ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 30.6.2025.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria “Deliu 3D” sh.p.k., me shkresën e datës 11.6.2025, protokolluar në ERE me nr. 1385/11 prot., datë 16.6.2025, ka njoftuar ERE-n, lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, duke bërë me dije ndër të tjera se: “..... spostimi në afat kohor i disbursimit të kredisë dhe në këtë mënyrë punimet për ndërtimin e hidrocentralit kanë rifilluar në datën 1.6.2025 dhe që punimet në ndërtimin e HEC ‘Shirokut’ do t’i përmbahen afateve kohore të lejes së ndërtimit.”.

- Në referencë të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 107, datë 23.5.2025, për dhënie autorizimi nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Deliu 3D” sh.p.k. si mjet garantimi i detyrimeve ndaj të tretëve, nga konstatimet e vendimit, shoqëria “Deliu 3D” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1385 prot., datë 19.3.2025, ka paraqitur aplikimin për marrjen e autorizimit për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga marrëdhënia kontraktuale me palën kredidhënëse, bankën “OTP Albania” sh.a.

- Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të depozituar nga shoqëria, me *email*-in e protokolluar në ERE më datë 8.4.2025, i cili është dërguar zyrtarisht me shkresën nr. 1385/1 prot.,

datë 9.4.2025, shoqërisë i është evidentuar se kontrata e kredisë është nënshkruar më datë 16.12.2024, përpara se shoqëria të licencohej nga ERE, me vendimin e Bordit nr. 51/2025 dhe si pasojë përpara se shoqërisë t’i lindë detyrimi ligjor për të marrë autorizimin e ERE-s për vendosjen e kësaj barre.

- Për sa më sipër, vlerësohet se shoqërisë “Deliu 3D” sh.p.k. nuk i janë shkaktuar vonesa nga vendimmarrja e ERE-s, lidhur me dhënien e autorizimit, por nga mangësitë e konstatuara në procedurën e ndjekur, si dhe dokumentacionin e paraqitur në aplikim.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Sa i përket kërkesës së shoqërisë “Deliu 3D” sh.p.k., lidhur me shtyrjen e datës së përcaktuar për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, sipas afatit kohor të lejes së ndërtimit, vlerësojmë se: “Kushti i vendosur në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51, datë 3.3.2025, lidhur me fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, brenda datës 30.6.2025, është vendosur si rrjedhojë e deklaramit të bërë nga vetë shoqëria në shtojcën 2 të aplikimit për licencim.”.

- Për sa i përket ndryshimit të afatit të fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, sipas afatit të vendosur nga leja e ndërtimit e kërkuar nga shoqëria, sipas llogaritjeve të bëra për qëllim të kësaj vendimmarrje, leja e ndërtimit e zbardhur me nr. 1809/3 prot., datë 13.6.2024, me objekt: Ndërtimi i HEC “Shiroku”, në përroin e Hotomizës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan, sipas vendimit nr. 20, datë 1.8.2023, të Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), ka një afat prej 30-muajsh, i cili përfundon më datë 31.1.2026.

- Gjithashtu, në nenin 9, pika 2 të kontratës së nënshkruar mes shoqërisë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nr. 1894 rep., nr. 1092/3 kol., datë 29.8.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Shiroku’, me kapacitet prodhues 1.6 mw, në pellgun ujëmbledhës të përroit të Holtës dhe përroit të Hotomizës, me derdhje në përroin e Holtës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan”, përcaktohet se mbajtësi i miratimit për ndërtim merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin, brenda 30 muajve nga data e marrjes së të gjitha lejeve për fillimin e punimeve, sikurse është parashikuar në



grafikun e punimeve të paraqitura në aneksin 2, bashkëlidhur kontratës.

- Vlerësojmë se pavarësisht tejkalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51, datë 3.3.2025, lidhur me fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, shoqëria është ende brenda afateve të përcaktuara për vënien në punë të hidrocentralit në kontratën e nënshkruar me MIE-n dhe në lejen e ndërtimit të dhënë nga KKT-ja (deri më datë 31.1.2026).

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet se: “një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj, ku anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë”, vlerësojmë që pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 94, datë 28.4.2025, duhet të ndryshohet si më poshtë vijon:

Ishte: Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 30.6.2025.

Bëhet: Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 31.1.2026.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2, e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51, datë 3.3.2025, ndryshon dhe bëhet:

“2. Shoqëria të fillojë operimin/ushtimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 31.1.2026.”.

2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “Deliu 3D” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “FTL” sh.a., “OSSH” sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 167, datë 31.7.2025

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 107, DATË 23.5.2025, “MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË ‘DELIU 3D’ SHPK, SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 1385/15 prot., datë 25.7.2025, “Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë ‘Deliu 3D’ sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Deliu 3D” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 107, datë 23.5.2025, ka miratuar dhënien e autorizimit për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Deliu 3D” sh.p.k. si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse, “Banka OTP Albania” sh.a., duke përcaktuar ndër të tjera, që: Shoqëria “Deliu 3D” sh.p.k duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj [....].

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria



- ERE, me shkresën nr. 1385/13 prot., datë 8.7.2025, i është drejtuar shoqërisë “Deliu 3D” sh.p.k. me njoftimin për zbatimin e pikës 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 107, datë 23.5.2025, për dorëzimin pranë ERE të ekstraktit historik të përditësuar të regjistrit tregtar, pas pasqyrimit tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) të kolateralit mbi kuotat, i cili ka për qëllim të vërtetojë, përmes dokumentacionit zyrtar, se vendosja e barrës sigurose mbi kuotat është regjistruar në regjistrin tregtar të QKB-së, në përputhje me autorizimin e dhënë nga ERE.

- Shoqëria “Deliu 3D” sh.p.k., me shkresën nr. 10/7 prot., datë 10.7.2025, protokolluar në ERE me nr. 1385/14 prot., datë 10.7.2025, ka përcjellë kopjen e ekstraktit historik të regjistrit tregtar të shoqërisë, ku reflektohet depozitimi në QKB i marrëveshjes sigurose nr. 1983 rep, nr. 1001 kol., datë 5.5.2025, për krijimin e një barre sigurose në favor të bankës “OTP Albania” sh.a., për krijimin e një barre të radhës së parë mbi çdo të drejtë, titull, interes të tyre mbi kuotat që përfaqësojnë 100% të kapitalit të nënshkruar të Barrëdhënësve në shoqërinë tregtare “Deliu 3D” sh.p.k.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Përditësimi i ekstraktit historik të regjistrit tregtar të shoqërisë “Deliu 3D” sh.p.k. ka ndodhur në datën 20.6.2025 në tejkallim të afatit të përcaktuar në vendimarrjen e ERE-s. Në këto kushte, pavarësisht tejkallimit të afatit të sipërcituar, gjykojmë se me depozitimin e dokumentacionit të sipërcituar, shoqëria ka plotësuar kushtin e përcaktuar në pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 107, datë 23.5.2025, duke qenë se qëllimi i vendosjes se kushtit ishte depozitimi i ekstraktit dhe tejkallimi i afatit nuk ka shkaktuar pasoja të cilat mund të cenonin ligjshmërinë e vendimit në tërësi, vlerësohet që kjo pikë të shfuqizohet.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet se një akt administrativ mund të anulohet apo tëshfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj, ku anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë, vlerësojmë që pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 107, datë 23.5.2025, duhet të shfuqizohet.

- Në vijim të shfuqizimit të pikës 3, lind, gjithashtu, nevoja për ndryshimin e pikës 5 të po këtij vendimi, nga formulimi aktual: “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi”, në: “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2 të këtij vendimi”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 107, datë 23.5.2025, shfuqizohet.

2. Pika 5 e vendimit të BORDIT të ERE-s nr. 107, datë 23.5.2025, ndryshon si vijon: “5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushtit të vendosur në pikën 2 të këtij vendimi”.

3. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “DELIU 3D” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 168, datë 31.7.2025

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E
BORDIT TË ERE-s NR. 191, DATË
6.6.2023, “MBI KËRKESËN E
SHOQËRISË ‘SPV BLUE 1’ SHPK, PËR
MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE
PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET
VENDOSJES SË BARRËS SIGURUESE)
TË ASETVE TË PALUAJTSHME TË
CENTRALIT FOTOVOLTAÏK ‘BLUE 1’,
NË FAVOR TË ‘GREEN FOR GROWTH
FUND SOUTHEAST EUROPE S.A,
SICAV-SIF”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, me nr. 2117/2 prot., datë 25.7.2025, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 191, datë 6.6.2023, ‘Mbi kërkesën e shoqërisë ‘SPV Blue 1’ sh.p.k., për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguruese) të aseteve të paluajtshme të centralit fotovoltaik ‘Blue 1’, në favor të Green for Growth Fund Southeast Europe S.A, SICAV-SIF”.

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “SPV Blue 1” sh.p.k.

- Shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 116, më datë 24.5.2022 për centralin fotovoltaik me kapacitet 50 mw, në Sheq Marinas. Ndërsa me vendimin nr. 191, datë 6.6.2023, Bordi i ERE-s vendosi të miratojë kërkesën e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k., për dhënien e autorizimit për vendosjen e barrës siguruese mbi asetet e paluajtshme të centralit fotovoltaik “Blue 1”, në favor të “Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., SICAV-SIF”.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2117 prot., datë 17.7.2025, ka paraqitur pranë ERE-s kërkesën për ndryshimin e pikës 1 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 191, datë 6.6.2023, në funksion të zëvendësimit të barrëmarrësit ekzistues, “Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., SICAV-SIF”, me dy kredidhënës të rinj: një bankë e regjistruar në Shqipëri dhe një bankë e huaj, pjesë e të njëjtut grup financiar.

- Në kuadër të shqyrtimit të kësaj kërkeje, shoqëria ka depozituar dokumentacionin përkatës, përfshirë: kontratën e re të kredisë të lidhur më datë 25.6.2025 ndërmjet palëve të përfshira në marrëdhënien financiare, ku njëra prej bankave vepron si agjent kredie dhe agjent garancie; marrëveshjen për vendosjen e barrës siguruese mbi asetet ekzistuese dhe ato që do të krijohen të centralit fotovoltaik; listën e aseteve objekt barrësimi dhe vlerat përkatëse; si dhe deklaratën e pëlqimit me shkrim të kredidhënësit ekzistues për çregjistrimin e barrës aktuale dhe vijimin e procedurës së rifinancimit.

- Shoqëria deklaroi se qëllimi i rifinancimit është optimizimi i strukturës së kapitalit dhe realizimi i investimeve shtesë në teknologji magazinimi (*storage*), pa ndikuar në vazhdimësinë e aktivitetit të saj të licencuar.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Këto dokumente përfshijnë kontratën e kredisë dhe marrëveshjen për vendosjen e barrës siguruese mbi asetet e shoqërisë. Ky ndryshim lidhet me autorizimin për vendosjen e barrës siguruese mbi të njëjtat asetet të shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k., në kuadër të një marrëveshjeje të re kredie.

- “SPV Blue 1” sh.p.k. ka kërkuar që një pjesë e dokumentacionit të depozituar në ERE, përfshirë marrëveshjen e barrës siguruese, listën e aseteve dhe vlerat përkatëse, të dhënat për institucionet financuese dhe informacionin ekonomik e financiar të shoqërisë, të trajtohen si konfidenciale, me argumentin se publikimi i tyre cenon interesat tregtarë dhe marrëdhëniet kontraktore me palët financuese. Megjithatë, vlerësohet se, për arsye ligjore dhe në përputhje me parimin e transparencës së vendimmarrjes publike, të paktën disa nga këto elemente, si identiteti i kredidhënësve dhe lista e aseteve objekt i barrës, janë thelbësore për



përmbajtjen e aktit administrativ dhe nuk mund të përjashtohen nga publikimi.

- Të gjitha dokumentet janë dorëzuar në kopje të njësuara me origjinalin, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në funksion të sa parashtruar më sipër, vlerësohet se ndryshimi i kërkuar nga shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. përfshin zëvendësimin e subjektit përfitues të barrës siguruese, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 191, datë 6.6.2023, konkretisht zëvendësimin e “Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., SICAV-SIF” me kredidhënësit e rinj “Banka e Parë e Investimeve – Albania” sh.a. dhe “First Investment Bank AD” (Bullgari), si dhe miratimin e marrëveshjeve të reja të lidhura në kuadër të rifinancimit të projektit, përfshirë kontratën e re të kredisë dhe marrëveshjen për barrën siguruese mbi të njëjtat asete të licencuara të shoqërisë.

- Në këtë kontekst, vlerësohet se autorizimi i dhënë me vendimin nr. 191/2023 duhet të përditësohet për të reflektuar situatën e re juridiko-financiare të shoqërisë, si rezultat i përfundimit të marrëdhënies me kredidhënësin e mëparshëm dhe lidhjes së një marrëveshjeje të re kredisë me subjekte të tjera financiare.

- Bazuar në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ku parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet nga organi që e ka nxjerrë, vlerësohet që pika 1 e dispozitivit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 191, datë 6.6.2023, të ndryshohet për të përfshirë përfituesit e rinj të barrës siguruese dhe për të zëvendësuar listën e aseteve të licencuara, të cilat do të jenë objekt i barrës së re, në përputhje me marrëveshjen e rifinancimit të paraqitur.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 191, datë 6.6.2023, ndryshon dhe bëhet: “Dhënia e autorizimit për vendosjen e një barre të re siguruese mbi asetet fikse të centralit fotovoltaiik ‘Blue 1’, në favor të ‘Banka e Parë e Investimeve – Albania’ sh.a. dhe ‘First Investment Bank AD’ (Bullgari), në kuadër të marrëveshjes të huas, për qëllime rifinancimi të detyrimeve ekzistuese ndaj ‘Green for

Growth Fund – Southeast Europe S.A., SICAV-SIF” (lista e aseteve bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 1” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

ANEKSI 1

LISTA E ASETEVE TË SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SHPK, TË CILAT VENDOSËN BARRË SIGURUESE NË FAVOR TË “BANKA E PARË E INVESTIMEVE – ALBANIA” SHA DHE “FIRST INVESTMENT BANK AD”

1. Panel diellor, me vlerë 27,467,324.72 euro;
2. Inverter, me vlerë 2,027,656.35 euro;
3. Transformatorë, me vlerë 2,035,961.53 euro dhe 801,921.72;
4. Pilota dhe struktura, me vlerë 8,941,567.37;
5. Kablllo dhe aksesore (pajisje LV) + Scada + Sistem CCTV, me vlerë 1,087,192.72;

Në total rezultojnë 42,361,624.40 euro (ose 4,144,661,331 lekë).

**VENDIM****Nr. 169, datë 31.7.2025****MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 147, DATË 24.4.2023, “MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË ‘SPV BLUE 1’ SHPK, SI MJET (BARRË SIGURUESE) PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ ‘GREEN FOR GROWTH FUND SOUTHEAST EUROPE S.A., SICAV-SIF’”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve me nr. 2116/1 prot., datë 25.7.2025, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 147, datë 24.4.2023, “Mbi dhënie e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë ‘SPV Blue 1’, si mjet (barrë siguruese) për garantimin e detyrimit ndaj ‘Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., SICAV-SIF’”, konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “SPV Blue 1” sh.p.k.

- Shoqëria “SPV BLUE 1” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 116, më datë 24.5.2022 për centralin fotovoltai me kapacitet 50 mw, në Sheq Marinas. Ndërsa me vendimin nr. 147, datë 24.4.2023, është miratuar dhënia e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k., si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj “Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., SICAV-SIF”.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria “SPV BLUE 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2116 prot., datë 17.7.2025, ka paraqitur pranë ERE-s kërkesën për ndryshimin e pikës 1 të vendimit të Bordit të ERE-

s nr. 147, datë 24.4.2023, me qëllim zëvendësimin e përfituesit ekzistues të barrës siguruese, “Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., SICAV-SIF”, me kredidhënës të rinj: “Banka e Parë e Investimeve – Albania” sh.a. dhe “First Investment Bank AD” (Bullgari).

- Kërkesa ka si objekt miratimin e vendosjes së një barre të re siguruese mbi kuotat e shoqërisë, në favor të kredidhënësve të rinj, në kuadër të rifinancimit të huas ekzistuese, nëpërmjet një marrëveshjeje të re kredie të nënshkruar më datë 25.6.2025. Sipas dokumentacionit të depozituar, barra siguruese do të vendoset mbi 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k.

- Në kuadër të shqyrtimit të kësaj kërkesë, shoqëria ka depozituar dokumentacionin përkatës, përfshirë: kontratën e re të kredisë dhe marrëveshjen për vendosjen e barrës siguruese mbi kuotat e shoqërisë; vendimin e Asamblesë së Ortakëve për miratimin e vendosjes së barrës siguruese mbi kuotat; deklaratën e administratorit mbi mungesën e barrëve të tjera të regjistruara mbi kuotat; miratimin paraprak me shkrim nga kreditori ekzistues “Green for Growth Fund Southeast Europe S.A., SICAV-SIF” për transferimin e barrës; si dhe vërtetimin nga Regjistri i Barrëve Siguruese mbi gjendjen e regjistrimeve ekzistuese.

- Shoqëria deklaron se qëllimi i kërkesës është zëvendësimi i kreditorit ekzistues dhe rifinancimi i detyrimeve aktuale përmes një marrëveshjeje të re kredie, duke ruajtur të pandryshuar objektin e barrës siguruese – kuotat e kapitalit të shoqërisë.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, vlerësohet se kërkesa e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k. për autorizimin e vendosjes së barrës siguruese mbi kuotat e saj është e mbështetur në dokumentacion të plotë dhe të rregullt. Objekt i barrës mbeten 100% e kuotave të kapitalit të shoqërisë, të njëjtat që janë përfshirë në autorizimin fillestar të dhënë me vendimin nr. 147, datë 24.4.2023, të Bordit të ERE-s.

- Marrëdhënia e re financiare është konsoliduar nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate kredie me dy banka të licencuara – “Banka e Parë e Investimeve – Albania” sh.a. dhe “First Investment Bank AD” (Bullgari) – të cilat kanë paraqitur dokumentacionin përkatës, përfshirë kontratën e kredisë dhe marrëveshjen për vendosjen e barrës mbi kuotat e shoqërisë.



- Në këtë kuadër, vlerësohet se objekti i autorizimit nuk pëson ndryshim thelbësor, ndërsa ndryshimi i propozuar lidhet me rifinancimin e marrëdhënies ekzistuese dhe zëvendësimin e kredidhënësit me dy institucione të tjera financiare, duke ruajtur natyrën dhe qëllimin e garancisë. Kërkesa konsiderohet e justifikuar në aspektin ekonomik dhe juridik dhe përmbush të gjitha kriteret për miratim nga ERE.

- Të gjitha dokumentet janë dorëzuar në kopje të njësuar me origjinalin, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në zbatim të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon mundësinë për ndryshimin e një akti administrativ nga organi që e ka nxjerrë, kur paraqiten rrethana të reja faktike apo juridike, si dhe në funksion të garantimit të sigurisë juridike dhe transparencës së vendimmarrjes administrative, vlerësohet se pika 1 e vendimit të Bordit të ERE nr. 147, datë 24.4.2023, duhet të ndryshohet për të reflektuar kreditorët e rinj – “Banka e Parë e Investimeve – Albania” sh.a. dhe “First Investment Bank AD” (Bullgari) – si përfitues të barrës siguruese mbi kuotat e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit të Bordit të ERE nr. 147, datë 24.4.2023, ndryshohet dhe bëhet: “Dhënie e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “SPV blue 1” sh.p.k. si mjet (barrë siguruese) për garantimin e detyrimeve që burojnë nga kontrata e kredisë e lidhur më datë 25.6.2025, në favor të kreditorëve “Banka e Parë e Investimeve – Albania” sh.a. dhe “First Investment Bank AD” (Bullgari)”.

2. Drejtoria Juridike dhe zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë “SPV Blue 1” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i

mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 171, datë 31.7.2025

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 30 MW

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38 pika 1, germa “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1841/6 prot., datë 25.7.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘EZ-5 Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1841 prot., datë 10.6.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 30 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 123, datë 24.6.2025, vendosi të fillojë procedurën për



licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 25.6.2025 dhe 26.6.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 24.7.2025), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1841/3 prot., datë 26.6.2025, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e informacionit/dokumentacionit të aplikimit të konstatuar të paplotësuar ose të plotësuar pjesërisht.

- Me shkresën nr. 1841/4 prot., datë 26.6.2025, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e procedurës së licencimit, duke i kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur kthim përgjigjeje.

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1841/5 prot., datë 4.7.2025, ka depozituar informacionin/dokumentacionin plotësues për këtë aplikim.

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.4.2025 është miratuar *ndërtimi i centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse i cili nuk është objekt koncesioni, në Zonën Kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k.*

- Shoqëria ka nënshkruar me MIE-n kontratën nr. 4456 rep., nr. 2040 kol., datë 27.5.2025, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 30 MW, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3038, Njësia

Administrative Povelçë, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘EZ-5 Energy’ sh.p.k.”.

- Shoqëria është pajisur me vendim për VNM paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), më 13.2.2025, për ndërtimin e impiantit fotovoltaike me fuqi 30 MW.

Kushtet dhe afatet ligjore:

- Kontrata e nënshkruar me MIE-n me nr. 4456 rep., nr. 2040 kol., datë 27.5.2025, parashikon një afat 49-vjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Shoqëria ka depozituar garancinë teknike të jetëgjatësisë së centralit me afat vlefshmërie 30-vjeçare, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet që të jetë për 30 vjet.

- Për sa i përket miratimit të pikës së lidhjes së centralit fotovoltaike me rrjetin e transmetimit, rezulton se shoqëria është brenda afatit të përcaktuar në miratimin në parim të dhënë nga OST sh.a., nëpërmjet shkresës së datës 10.2.2025, por duke qenë se nuk është pajisur ende me miratimin përfundimtar apo nënshkrimin e marrëveshjes përkatëse, duke marrë në konsideratë dhe faktin që me marrjen e autorizimit për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centralit fotovoltaike, lidhja e tij me rrjetin elektrike është e garantuar, vlerësohet që shoqërisë t’i lihet kusht që përpara fillimit të operimit të depozitojë në ERE marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a.

- Shoqëria aktualisht disponon një VNM të vlefshme deri më 13.2.2027, e cila ndodhet brenda afateve të përcaktuara në kontratën me MIE-n, ku përcaktohet se duhet të ndërtojë dhe të vendosë në punë centralin brenda datës 30.4.2028.

- Po ashtu, në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës së nënshkruar me MIE-n vlerësohet që shoqërisë t’i lihet kusht që me fillimin e operimit/ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, por jo më vonë se 60 ditë nga ky fakt, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për testimin e veprës.

- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi në rast të depozitimit të sa lënë detyrë



shoqërisë dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “EZ-5 Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet prodhues 30 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

2. Përpara fillimit të operimit, shoqëria duhet të depozitojë në ERE marrëveshjen e nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a., për miratimin e pikës së lidhjes së centralit fotovoltaiik me rrjetin e transmetimit.

3. Shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k. duhet të fillojë operimin e centralit fotovoltaiik jo më vonë se data 31.12.2025.

4. Me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga ky fakt, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës.

5. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 2, 3 dhe 4, të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

6. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “EZ-5 Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OST sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 172, datë 31.7.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET PRODHUES 12 MW

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2122/1 prot., datë 21.7.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Global Technical Mechanics’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Global Technical Mechanics” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2122 prot., datë 18.7.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet prodhues 12 MW, me vendndodhje në zonën e Aeroportit të Kukësit, Njësia Administrative Shtiqën, Bashkia Kukës, qarku Kukës.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin



e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave (“a”, “b” dhe “c”), duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 1, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duke plotësuar të dhënat e subjektit, përfshirë emrin, NUIS-in, adresën, kontaktet dhe administratorin. Gjithashtu, aplikuesi deklaron se nuk i është hequr apo refuzuar më parë një licencë, angazhohet për zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullave të ERE-s, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas aneksit A.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave (“a” dhe “b”).

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- Këshilli i Ministrave ka miratuar vendimin nr. 175, datë 20.3.2025 *“Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike për vetprodhim dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën e Aeroportit të Kukësit, Njësia Administrative Shtiqën, Bashkia Kukës, qarku Kukës, nga shoqëria ‘Global Technical Mechanics’ sh.p.k.”.*

- Shoqëria ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 2718 rep., nr. 1082 kol., datë 23.5.2025 *“Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike për vetëprodhim, me kapacitet prodhues 12 MW dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën e aeroportit të Kukësit, Njësia Administrative Shtiqën, Bashkia Kukës, qarku Kukës, nga shoqëria ‘Global Technical Mechanics’ sh.p.k.”.*

- Shoqëria ka marrë miratimin e pikës së lidhjes nëpërmjet shkresës së “Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a. me nr. 10278/3 prot., datë 3.10.2024.

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1: Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

- Shoqëria duhet të informojë në rast se struktura organizative e depozituar është aktualisht funksionale apo do të jetë në të ardhmen. (germa “c”)

*Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal
Shoqëria duhet të depozitojë:*

- Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. (germa “a”)

- Dokumentacion vërtetues për mbështetjen financiare për realizimin e projektit. (germa “b”)

- Planin e biznesit. (germa “c”)

Pika 2: Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- Të dhënat për sa i përket datës së fillimit të operimit. (germa “a”)

- Kontratën me MIE-n në formatin original ose fotokopje të njësuar me origjinalin. (germa “b”)

- Miratimin e pikës së lidhjes nga OSSH sh.a. në formatin original ose fotokopje të njësuar me origjinalin. (germa “c”)

- VNM-në paraprake, si dhe të bëjë me dije në rast se ka filluar punimet për ndërtimin e centralit. (germa “e”)

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Global Technical Mechanics” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet prodhues 12 MW, me vendndodhje në zonën e Aeroportit të Kukësit, Njësia Administrative Shtiqën, Bashkia Kukës, qarku Kukës, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Global Technical Mechanics” sh.p.k., dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 173, datë 31.7.2025****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “GLOBAL TECHNICAL MECHANICS” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2123/1 prot., datë 23.7.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Global Technical Mechanics’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”.

konstatoi se:

- Shoqëria “Global Technical Mechanics” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2123 prot., datë 18.7.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezultoi se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.1, të Rregullores, aplikuesi ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit në përputhje me përcaktimet e aneksit A të Rregullores.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2, të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin

juridik dhe administrativ të kërkuar. Për sa i përket germës “a”, shoqëria ka dorëzuar ekstraktin historik të regjistrit tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), të datës 9.7.2025, nga ku rezultoi se është regjistruar më 29.3.2017, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.). Të dhënat për emrin, NUIS-in, adresën, kontaktet dhe administratorin përputhen me ato të paraqitura në aplikim. Për germën “b” janë paraqitur dëshmitë e penalitetit për subjektin dhe administratoren e tij, përmes dy vërtetimeve të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, të datave 9.7.2025 dhe 10.7.2025, nga të cilat rezultoi se si subjekti, ashtu edhe administratori nuk rezultojnë të dënuar.

- Në përputhje me nenin 9, pika 2.4, të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike. Në zbatim të germës “a”, shoqëria ka paraqitur parashikimin e sasisë së energjisë elektrike që planifikon të furnizojë për 5 vjetët në vijim. Lidhur me germën “b”, shoqëria ka bërë të ditur se për operimin në veprimtarinë e furnizimit do të përdorë sisteme IT të përshtatshme për procesin e faturimit, duke përfshirë opsione të tilla si Financa 5 (aktualisht në përdorim), Tridens, Methodia, SkyBill, apo çdo sistem tjetër ekuivalent. Gjithashtu, objektet do të pajisen me sistemin SCADA për monitorim dhe kontroll. Në zbatim të germës “d”, shoqëria ka deklaruar se klientët do të furnizohen në nivelet e tensionit 20 kV, 35 kV, 110 kV dhe 220 kV dhe se realizimi i matjes për klientët do të bëhet përmes matësve të vendosur dhe të miratuar nga operatori i sistemit.

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 9**Formati dhe dokumentacioni për aplikim**

Pika 1.1, “Formati i aplikimit, sipas përcaktimeve të shtojcës 1”

- Shoqëria duhet të depozitojë shtojcën 1 të plotësuar në të gjithë zërat e saj.

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”

- Shoqëria duhet të bëjë saktësimet përkatëse në lidhje me strukturën e saj, duke informuar dhe në lidhje me stafin që ka aktualisht efektiv (germa “c”).

Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”

Shoqëria duhet të depozitojë:

- Vërtetimin që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore (germa “a”).



- Dokumentacion vërtetues të disponimit të mbështetjes financiare për të garantuar ushtrimin e të paktën 1 (një) muaji veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike (germa “b”).

- Planin e biznesit të përditësuar (germa “c”).

Pika 2.4, “Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike”

- Shoqëria duhet të informojë mbi mënyrën e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit (germa “c”).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Global Technical Mechanics” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Global Technical Mechanics” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 174, datë 31.7.2025

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “DIMAX ALBANIA” SHPK SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 9, pika 8, dhe 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit,

ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1950/3 prot., datë 22.7.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Dimax Albania’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj të tretëve”,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “Dimax Albania” sh.p.k. është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1950 prot., datë 26.6.2025, ka paraqitur kërkesën për të marrë autorizimin e ERE-s për vendosjen e barrës siguruese mbi kuotat e saj si mjet për të garantuar shlyerjen e detyrimit ndaj bankës “Raiffeisen Bank” sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Shoqëria “Dimax Albania” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 308, datë 30.11.2022.

- Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të depozituar, ERE, me shkresën nr. 1950/1 prot., datë 9.7.2025, i ka evidentuar shoqërisë mungesat në dokumentacionin e aplikimit, të cilat konsistojnë në mungesën e informacionit mbi ekzistencën ose jo të ndonjë korrespondence me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), lidhur me këtë aplikim; mungesën e vendimit gjyqësor që vërteton ndryshimin e ortakut/aksionarit kryesor të subjektit të licencuar, nëse një i tillë ekziston; mungesën e deklaramit nëse ndonjë pjesë e dokumentacionit të dorëzuar kërkohet të trajtohet si konfidencial.

3. Dorëzimi i dokumentacionit plotësues



- Shoqëria, me shkresën nr. 1950/2 prot., datë 17.7.2025, ka depozituar të plotë dokumentacionin e kërkuar për këtë aplikim.

4. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “Dimax Albania” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni, në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollojnë interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollojnë interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2022, si vijon:

- neni 5, pika 2 – kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë, në përputhje me kërkesat e rregullores.

Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- neni 5, pika 4 – dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike;

- neni 5, pika 5 – shoqëria nuk ka bërë me dije nëse ka pjesë të dokumentacionit të këtij aplikimi që konsiderohet se nuk duhet të jetë e hapur për publikim, ndaj konsiderohet se nuk e kërkon këtë kufizim.

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 8:

- pika 1 – janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet për vendosjen e barrës sigurose, përshkrimi i detyrimeve dhe deklarata mbi statusin e kuotave;

- pika 2 – janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror si më poshtë vijon:

- germa “a” – ekstrakti historik i regjistrit tregtar;

- germa “b” – vendimi i organeve drejtuese: është depozituar vendimin i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakut të vetëm të saj, me nr. 19, datë 23.8.2023, që miraton vendosjen e barrës sigurose mbi aksioneve aktuale dhe të ardhshme të shoqërisë. Vlen të theksojmë/saktësojmë se në kuptim të këtij aplikimi dhe sa shprehur, gjithashtu, në marrëveshjen e nënshkruar me bankën ku citohet vendosja e barrës sigurose mbi 100% të kuotave të shoqërisë;

- germa “c” – marrëveshjen përkatëse:

- kontratë kredie nr. 5472 rep., nr. 1483 kol., datë 23.8.2023, të nënshkruar ndërmjet “Raiffeisen Bank” sh.a. (në cilësinë e kredidhënësit), shoqërisë “Dimax Albania” sh.p.k. (në cilësinë e kredimarrësit) dhe shoqërisë “Hydropower” sh.p.k. (në cilësinë e bashkëkredimarrësit), me qëllim financimin e investimit për zhvillimin dhe përfundimin e projektit fotovoltaiq;

- pika 3 – shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Dimax Albania” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve, nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohej nga kuadri ligjor ose nga marrëveshjet kontraktuale në fuqi.

- Vendosja e këtij kushti bëhet për të garantuar se autorizimi i dhënë nga ERE mbetet i kufizuar vetëm në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj rregullatore, pa ndërhyrë apo anashkaluar detyrimet ligjore ose kontraktuale që mund të ketë shoqëria ndaj autoriteteve të tjera ose palëve të përfshira në marrëdhënie financiare apo tregtare. Në këtë rast, duke qenë se marrëveshja është nënshkruar me bankë vendase, është përgjegjësi e shoqërisë të respektojë çdo detyrim tjetër jashtë kompetencës së ERE-s që mund të rrjedhë nga këto marrëveshje.

- Shoqëria detyrohet të njoftojë ERE-n në rast të heqjes së barrës sigurose ose të ekzekutimit të saj të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Dimax Albania” sh.p.k. si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse “Raiffeisen Bank” sh.a. (për kontratën datë 23.8.2023).

2. Dhënia e Autorizimit nga ERE, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, nuk e çliron shoqërinë “Dimax Albania” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohej nga këto organe.



3. Shoqëria duhet të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Dimax Albania” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 175, datë 31.7.2025

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “CONSTRUCTION ENERGY PARTS (C.E.P)” SHPK SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 9, pika 8, dhe 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96,

datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1951/3 prot., datë 22.7.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Construction Energy Parts (C.E.P)’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj të tretëve”,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “Construction Energy Parts (C.E.P)” sh.p.k. është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1951 prot., datë 26.6.2025, ka paraqitur kërkesën për të marrë autorizimin e ERE-s për vendosjen e barrës siguruese mbi kuotat e saj si mjet për të garantuar shlyerjen e detyrimit ndaj bankës “Raiffeisen Bank” sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Shoqëria “Construction Energy Parts (C.E.P)” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 306, datë 30.11.2022.

- Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të depozituar, ERE, me shkresën nr. 1951/1 prot., datë 9.7.2025, i ka evidentuar shoqërisë mungesat në aplikim, të cilat konsistojnë në: njoftimin nëse ka pasur korrespondencë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), në lidhje me këtë aplikim; informimin apo depozitim të një vendimi gjyqësor, në rast se ekziston, ku është vendosur ndryshimi i ortakut/aksionarit kryesor të subjektit të licencuar; si dhe sqarimin nëse ndonjë pjesë e dokumentacionit të dorëzuar kërkohet të trajtohet si konfidenciale.

3. Dorëzimi i dokumentacionit plotësues

- Shoqëria, me shkresën nr. 1951/2 prot., datë 17.7.2025, ka depozituar të plotë dokumentacionin e kërkuar për këtë aplikim.

4. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “Construction Energy Parts (C.E.P)” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit



nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2022, si vijon:

- neni 5, pika 2 – kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë, në përputhje me përcaktimet e rregullores.

Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- neni 5, pika 4 – dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike;

- neni 5, pika 5 – shoqëria nuk ka bërë me dije nëse ka pjesë të dokumentacionit të këtij aplikimi që konsiderohet se nuk duhet të jenë të hapura për publikim, ndaj konsiderohet se nuk e kërkon këtë kufizim.

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 8:

- pika 1 – janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet për vendosjen e barrës siguruese, përshkrimi i detyrimeve dhe deklarata mbi statusin e kuotave;

- pika 2 – janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror si më poshtë vijon:

- germa “a” – ekstrakti historik i regjistrit tregtar;

- germa “b” – vendimi i organeve drejtuese: është depozituar vendimin i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakut të vetëm të saj, me nr. 13, datë 23.8.2023, që miraton vendosjen e barrës siguruese mbi aksionet aktuale dhe të ardhshme të shoqërisë. Vlen të theksojmë/saktësojmë se në kuptim të këtij aplikimi dhe sa shprehur, gjithashtu, në marrëveshjen e nënshkruar me bankën ku citohet vendosja e barrës siguruese mbi 100% të kuotave të shoqërisë;

- germa “c” – marrëveshjen përkatëse:

- kontratë kredie nr. 5466 rep., nr. 1478 kol., datë 23.8.2023, të nënshkruar ndërmjet “Raiffeisen Bank” sh.a. si kredidhënësi, shoqërisë “Construction Energy Parts (C.E.P)” sh.p.k., si kredimarrësi dhe shoqërisë “Hydropower” sh.p.k., si bashkëkredimarrës, me qëllim financimin e investimit për zhvillimin dhe përfundimin e projektit fotovoltaiq;

- pika 3 – shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë, “Nënshkruar ndërmjet ‘Raiffeisen Bank’ sh.a. si kredidhënësi, shoqërisë ‘Construction Energy Parts (C.E.P)’ sh.p.k., si kredimarrësi dhe shoqërisë ‘Hydropower’ sh.p.k., si bashkëkredimarrës, me anë të së cilës banka është dakord t’i japë kredimarrësit kredi, me qëllim financimin e investimit për zhvillimin dhe përfundimin e projektit fotovoltaiq” sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve, nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohej nga kuadri ligjor ose nga marrëveshjet kontraktuale në fuqi.

- Vendosja e këtij kushti bëhet për të garantuar se autorizimi i dhënë nga ERE mbetet i kufizuar vetëm në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj rregullatore, pa ndërhyrë apo anashkaluar detyrimet ligjore ose kontraktuale që mund të ketë shoqëria ndaj autoriteteve të tjera ose palëve të përfshira në marrëdhënie financiare apo tregtare. Në këtë rast, duke qenë se marrëveshja është nënshkruar me bankë vendase, është përgjegjësi e shoqërisë të respektojë çdo detyrim tjetër jashtë kompetencës së ERE-s që mund të rrjedhë nga këto marrëveshje.

- Shoqëria detyrohet të njoftojë ERE-n në rast të heqjes së barrës siguruese ose të ekzekutimit të saj të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Construction Energy Parts (C.E.P)” sh.p.k si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse “Raiffeisen Bank” sh.a. (për kontratën datë 23.8.2023).

2. Dhënia e Autorizimit nga ERE, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, nuk e çliron shoqërinë “Construction Energy Parts (C.E.P)” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/ miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohej nga këto organe.

3. Shoqëria duhet të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.



4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Construction Energy Parts (C.E.P)” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 176, datë 31.7.2025

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “HYDROPOWER” SHPK SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 9, pika 8, dhe 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollojnë interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollojnë interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1949/4 prot., datë 23.7.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Hydropower’

sh.p.k. për dhënie e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj të tretëve”,

Konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënie e autorizimit për shoqërinë “Hydropower” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1949 prot., datë 26.6.2025, ka paraqitur kërkesën për të marrë autorizimin e ERE-s për vendosjen barrës sigurorese mbi kuotat e saj si mjet për të garantuar shlyerjen e detyrimit ndaj bankës “Raiffeisen Bank” sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Shoqëria “Hydropower” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 307, datë 30.11.202 në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet prodhimi 2 MW, me vendndodhje në zonën Povelçë, qarku Fier.

- Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të depozituar, ERE, me shkresën nr. 1949/1 prot., datë 9.7.2025, i ka evidentuar shoqërisë informacionin dhe dokumentacionin e konstatuar si të munguar në këtë aplikim, i cili konsiston në vendimin e organeve drejtuese në lidhje me dakordësinë për vendosjen e kuotave/aksioneve të subjektit të licencuar si mjete për garantimin e detyrimeve ndaj të tretëve; në njoftimin nëse ka pasur korrespondencë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në lidhje me këtë aplikim; në informimin apo depozitimin e një vendimi gjyqësor, nëse ekziston, ku është vendosur ndryshimi i ortakut/aksionarit kryesor të subjektit të licencuar; si dhe në sqarimin nëse ndonjë pjesë e dokumentacionit të dorëzuar kërkohet të trajtohet si konfidenciale.

- ERE nëpërmjet e-mailit të protokolluar me nr. 1949/3 prot., datë 21.7.2025 i ka risjellë në vëmendje shoqërisë se duhet të depozitojë brenda afatit të përcaktuar në rregullore dokumentacionin e konstatuar të munguar, pasi, në të kundërt referuar nenit 9, pika 3 të rregullores: “Në rast se shoqëria nuk plotëson dokumentacionin/informacionin e kërkuar brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, kërkesa e të licencuarit për dhënie e autorizimit nga ERE qubet se nuk është regjistruar dhe i kthehet kërkuarit bashkë me aktet e tjerë”.



3. Dorëzimi i dokumentacionit plotësues

- Me e-mailin e datës 22.7.2025, shoqëria ka bërë me dije se përgjigjen përkatëse e kanë depozituar pranë sekretarisë së ERE-s, me nr. 136 prot., datë 21.7.2025, brenda afatit ligjor të përcaktuar nga rregullorja në fuqi.

- Rezulton se me shkresën e sipërcituar, protokolluar në ERE me nr. 1949/2 prot., datë 21.7.2025, shoqëria ka depozituar sa kërkuar duke plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për aplikim.

4. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “Hydropower” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2022, si vijon:

- **Neni 5, pika 2** – kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë, në përputhje me kërkesat e rregullores.

Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- **Neni 5, pika 4** – dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike.

- **Neni 5, pika 5** – shoqëria nuk ka bërë me dije nëse ka pjesë të dokumentacionit të këtij aplikimi që konsiderohet se nuk duhet të jetë e hapur për publikim, ndaj konsiderohet se nuk e kërkon këtë kufizim.

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 8:

- **Pika 1** – janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet për vendosjen e barrës sigurose, përshkrimi i detyrimeve dhe deklarata mbi statusin e kuotave.

Pika 2 – janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror si më poshtë vijon:

- **Germa “a”** – ekstrakti historik i regjistrit tregtar.

- **Germa “b”** – vendimi i organeve drejtuese: është depozituar vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakut të vetëm të saj me nr. 39, datës 23.8.2023, që miraton vendosjen e barrës sigurose mbi aksioneve aktuale dhe të ardhshme të shoqërisë. Vlen të theksojmë/saktësojmë se në kuptim të këtij aplikimi dhe sa shprehur gjithashtu në marrëveshjen e nënshkruar me bankën ku citohet vendosja e barrës sigurose mbi 100% të kuotave të shoqërisë.

- **Germa “c”** – marrëveshjen përkatëse:

- **Kontratë kredie, nr. 5460 rep., nr. 1472 kol., datë 23.8.2023**, të nënshkruar ndërmjet “Raiffeisen Bank” sh.a. si kredidhënësi dhe shoqërisë “Hydropower” sh.p.k., si kredimarrësi, me anë të së cilës Banka bie dakord t’i japë kredimarrësit kredi, me qëllim financimin e investimit për zhvillimin e Projektit (ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike).

- **Pika 3** – shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “nënshkruar ndërmjet “Raiffeisen Bank” sh.a. si kredidhënësi dhe shoqërisë “Hydropower” sh.p.k., si kredimarrës, me anë të së cilës Banka bie dakord t’i japë kredimarrësit kredi, me qëllim financimin e investimit për zhvillimin dhe përfundimin e projektit fotovoltaike” sh.p.k., si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve, nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga kuadri ligjor ose nga marrëveshjet kontraktuale në fuqi.

- Vendosja e këtij kushti bëhet për të garantuar se autorizimi i dhënë nga ERE mbetet i kufizuar vetëm në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj rregullatore, pa ndërhyrë apo anashkaluar detyrimet ligjore ose kontraktuale që mund të ketë shoqëria ndaj autoriteteve të tjera ose palëve të përfshira në marrëdhënie financiare apo tregtare. Në këtë rast, duke qenë se marrëveshja e është nënshkruar me bankë vendase, është përgjegjësi e shoqërisë të respektojë çdo detyrim tjetër jashtë kompetencës së ERE-s që mund të rrjedhë nga këto marrëveshje.



- Shoqëria detyrohet të njoftojë ERE-n në rast të heqjes së barrës siguruese ose të ekzekutimit të saj të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Hydropower” sh.p.k., si mjet për të garantuar përmbushjen e detyrimit ndaj palës kredidhënëse “Raiffeisen Bank” sh.a. (për kontratën datë 23.8.2023).

2. Dhënia e Autorizimit nga ERE sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi nuk e çliron shoqërinë “Hydropower” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohej nga këto organe.

3. Shoqëria duhet të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Hydropower” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

NDREQJE GABIMI MATERIAL

Në vendimin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, “Çështja Maçi kundër Shqipërisë” (kërkesa nr. 21051/10), datë 4.7.2024, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 141, datë 8.8.2024, bëhet korrigjimi si më poshtë:

Pika 40 e vendimit ishte:

40. Gjykata vëren më tej se Shteti i paditur ka një detyrim të papërmbushur **për të zbatuar vendimin e vitit 2006, të ndryshuar nga vendimi i vitit 2008**. Në të njëjtën kohë, Gjykata thekson se i takon më së shumti Shtetit të paditur që të zgjedhë mjetet që do të përdoren në rendin e tij juridik të brendshëm për të përmbushur detyrimin e tij ligjor, sipas nenit 46 të Konventës (shihni *Shofman kundër Rusisë*, nr. 74826/01, § 53, 24 nëntor 2005, me referenca të mëtejshme). Në këtë çështje, nëse një autoritet vendas i pavarur konfirmon pa mëdyshje se zbatimi i vendimeve përfundimtare të brendshme është i pamundur (për shembull, për shkak të interesave të detyrueshme dhe legjitime publike ose private), i takon Shtetit të paditur që të zbatojë me shpejtësi masat e duhura për të korrigjuar situatën individuale të kërkuarve (shihni, *mutatis mutandis*, *Tarverdiyev kundër Azerbajxhanit*, nr. 33343/03, § 66, 26 korrik 2007).

Bëhet:

40. Gjykata vëren më tej se Shteti i paditur ka një detyrim të papërmbushur **për të zbatuar vendimet gjyqësore që mbeten të ekzekutueshme**. Në të njëjtën kohë, Gjykata thekson se i takon më së shumti Shtetit të paditur që të zgjedhë mjetet që do të përdoren në rendin e tij juridik të brendshëm për të përmbushur detyrimin e tij ligjor, sipas nenit 46 të Konventës (shihni *Shofman kundër Rusisë*, nr. 74826/01, § 53, 24 nëntor 2005, me referenca të mëtejshme). Në këtë çështje, nëse një autoritet vendas i pavarur konfirmon pa mëdyshje se zbatimi i vendimeve përfundimtare të brendshme është i pamundur (për shembull, për shkak të interesave të detyrueshme dhe legjitime publike ose private), i takon Shtetit të paditur që të zbatojë me shpejtësi masat e duhura për të korrigjuar situatën individuale të kërkuarve (shihni, *mutatis mutandis*, *Tarverdiyev kundër Azerbajxhanit*, nr. 33343/03, § 66, 26 korrik 2007).

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë

